



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**AC-I-16-0027**

**Në çështjen juridike të:**

*Ankuesi*

**M.E. Rahovec.**

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Mr. Sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-VI-13-0349, i datës 20 janar 2016 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 19 shtator 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e ankuesit, refuzohet si e pa bazuar**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS, C-VI-13-0349, i datës 20 janar 2016.**

### **3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

#### **Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike**

Më 27 mars 2013, ankuesi M.E. , ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me numër PRZ012 – 04400 të datës 14 mars 2013 me të cilin i është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në shumë prej 462.00 €. Ankuesi ka pohuar se ka qenë në listën e pagave deri më 03 mars 2006 kur edhe është privatizuar fabrika "N " dhe se në fabrikë ka punuar pa ndërprerje që nga data 12 maj 1986 deri më datë 03 mars 2006 kur është privatizuar NSH-ja. Si provë ankesës i ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës e cila është mbyllur më 03/03/2006.

Më 27 qershor 2014, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje duke pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike si dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, po ashtu e paditura ka pohuar se ankuesi nuk ishte pjesë e listës së pagave dhe pagesave për 12 muajt e fundit para privatizimit të NSH-së dhe se me këtë nuk plotësohen kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe se atij nuk i takon e drejta për të pranuar kompensimin e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Si provë ka bashkangjitur listën e te ardhurave personale për muajin mars të vitit 2006 dhe për vitin 2005.

Më 04 gusht 2014, ankuesi ka parashtruar përgjigje në mbrojtjen e AKP-së duke pohuar se mbetet pranë kërkesave për pagesën e borgjit nga e paditura.

Më 09 shtator 2014, e paditura AKP-ja ka parashtruar kundërpërgjigje, duke propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i atakuar i Autoritetit të Likuidimit.

Gjyqtari i vetëm i Kolegjit të Specializuar, duke vepruar sipas urdhrit delegues, me datë 20 janar 2016 ka nxjerrë Aktgjykim C-IV-13-0349 me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën dhe e ka vërtetuar Vendimin e AKP-së – Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ012-0440 të datës 01 mars 2013 si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Sipas arsytimit se nga provat e shqyrtuara del se ankuesit me asnjë veprim të AKP-së nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesi në ankesë por as në përgjigjen e tij nuk ka bashkangjitur asnjë provë si vendim apo njoftim të AKP-së me të cilin do të dëshmohej se atij nga e paditura në mënyrë të parakohshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Më 18 shkurt 2016 ankuesi ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-0349 të datës 20 janar 2016. Ankuesi ka pohuar se me aktgjykimin e atakuar nuk pajtohet sepse nuk i janë marrë parasysh të drejtat e kërkuara gjer më tani e që janë në lëndën C-IV-13-0349, po ashtu ka pohuar se të hollat i takojnë dhe për këtë apelon dhe kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar.

Me 16 gusht 2016 e paditura AKP-ja ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën pasi që ankuesi ka dështuar të ofroje fakte të argumentuara për ta bërë të besueshme kërkesëpadinë e vet.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Me Aktgjykimin e atakuar, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar e kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit M.E. , pasi që

nga provat e shqyrtuara ka ardh në përfundim se ankuesit me asnjë veprim të AKP-së nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Ankuesi , në ankesën e ushtruar vetëm pohon se i takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, duke mos pretenduar ndonjë fakt tjetër dhe duke mos bashkangjitur ndonjë provë.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, Aktgjykimin e ankimuar dhe të gjitha provat në shkresat e lëndës erdhi në përfundimin se ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin e atakuar, pasi që vlerëson se ankuesi nuk e ka bërë të besueshme kërkesën e vet përderisa nuk ka bashkangjitur ndonjë provë relevante për të vërtetuar faktin se ai është pushuar nga puna si rrjedhojë e veprimit të ndërmarrë nga AKP-ja, fakt i cili duhet të provohet me qëllim që ti njihet e drejta për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës. Andaj Kolegji i Apelit vie në përfundim të njëjtte sikurse Gjyqtari me kompetenca të deleguara, se ankuesit marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë si pasojë e ndonjë veprimi të AKP-së, pasi që në momentin e privatizimit të NSH-së, ankuesi nuk e ka provuar se ka qenë në listën e punëtorëve të NSH-së. Për më tepër nga Libreza e punës që ishte mbyllur më 03/3/2006 nënkupton se të njëjtit marrëdhënia e punës i ishte ndërprere dy vite para fillimi të procesit të likuidimit, 06/03/2008. Libreza e punës është një dokument me një vlerë të lartë provuese dhe shënimet zyrtare që i përmban ajo nuk mund të injorohen. Ankuesi nuk jep asnjë arsye tjetër të vlefshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këtë kohë.

Kolegji i Apelit vlerëson se plotësimi i kushteve me qëllim që ankuesit ti njihet e drejta për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës është i paraparë me nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, sipas të cilit duhet të plotësohen dy kushte ligjore për të pasur të drejtën në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe atë pushimi i punëtorit nga

puna dhe se ky pushim duhet të jetë si rrjedhojë e një veprimi të ndërmarre nga AKP-ja. Në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'iu njohur ankuesit e drejta e pretenduar, andaj edhe Kolegji i Apelit pajtohet plotësisht me aktgjykimin i Gjyqtarit me kompetenca të deleguara, duke e konsideruar sit ë drejtë dhe të bazuar në ligj.

Për këto arsye të theksuara më lartë, ankesa e ankuesit në tërësi është e pabazuar dhe rrjedhimisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Taksat gjyqësore:**

Në pajtim me nenin 13.9 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 19 shtator 2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_

## **URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT**

Lutemi ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Palët
- Gjyqtari i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-IV.-13-0349.

Ilmi Bajrami, Kryesues i Kolegjit të Apelit \_\_\_\_\_